

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MAVI Consulting” sh.p.k

Themeluesit qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Znj. Blerina Mali, e datelindjes 24.05.1999, e bija i Hysni-ut, lindur ne Stamboll/Turqi dhe banuese ne Rruga Muçaj, Nd.8; Hyrja 1; Ap. Banesë Private dhe me nr. Pasaporte BF2711382 dhe nr personal shqiptar J95524062O madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe,
Z. Alban Vidhi, i datelindjes 03.06.1990, i biri i Kujtim-it, lindur ne Durres/Shqiperi dhe banues ne Rruga Don Bosko, Kompleksi Fiori di Bosko, Kulla 3, Shkalla 2, Hyrja 18 dhe me nr. Pasaporte BD9564170 dhe nr. personal shqiptar J00603068K madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhen Ortak-et e Shoqerise “MAVI Consulting” sh.p.k

Sot me date **06.01.2025**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK
Neni 1
Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “MAVI Consulting” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Konsulence dhe sherbime ne fushen tregtise nderkombetare. Konsulence dhe sherbime biznesi dhe leje pune/qendrimi. Konsulence dhe sherbime studentore. Turizem shendetesor. Makina me qera. Guida turistike. Krijim dhe menaxhim faqe interneti. Perkthime turqisht-shqip dhe anasjelltas.

Neni 2
Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne “MAVI Consulting” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Rruga Don Bosko, Kompleksi Fiori di Bosko, Kulla 3, Shkalla 2, Hyrja 18 Tirane.

Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3
Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakut mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortakut do ta pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.



Kreu II
TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA
Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregetare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III
KAPITALI THEMELTAR
Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 2 (dy) kuota gjithsej.

Ortaket e shoqerise jane:

1. **Blerina Mali**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000 lek, qe perfaqeson **50% (pesedhjete %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;
2. **Alban Vidhi** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere 50.000 lek, qe perfaqeson **50% (pesedhjete %)** kapitalin themeltar te shoqerise;

Kreu IV
PERSONALITETI JURIDIK
Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V
ADMINISTRIMI
Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Alban Vidhi** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA
Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakeve te saj te vendosin nese do ta ndajne si dividend apo do ta shtojne ne kapitalin e shoqerise.



Ky Akt shtypet dhe nenshkruset ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njeften vlere ligjore.
Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku themelues

Blerina Mali



Ortaku themelues

Alban Vidhi

